



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 169, Datë 26.08.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “MAGNA SOLAR POWER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1756/1 prot., datë 19.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1756 prot., datë 12.08.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.1 gërmat “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “MAGNA POWER SOLAR” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën me nr. 10939 Rep., nr. 4910 kol., datë 01.08.2022;
 - Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. Marrëveshjen e lidhjes së re, nr. 8316/2 prot., datë 30.07.2024. për lidhjen e centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 09.05.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 MW.
- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimet e gjendjes gjyqësore, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin dhe shoqërinë “MAGNA POWER SOLAR” sh.p.k.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë strukturën organizative të shoqërisë.

Pika 1.3

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës/vërtetues për disponimin e shumës së kërkuar për të realizuar projektin, duke iu referuar përcaktimeve të kontratës me MIE-n për vlerën e investimit dhe parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiik dhe të bëjë me dije datën e fillimit të operimit.
- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë kontratën e plotë të nënshkruar me MIE-n, si dhe informacion/dokumentacion në lidhje me zbatimin e afateve të saj.
- **gërma “d”**: Aplikuesi duhet të dokumentojë fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake të depozituar (deri më 09.05.2024), përndryshe duhet të depozitojë një VNM të re.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI